

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



publika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtoria për Punë të Rezervimshme Administrativë  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-16832  
Data/Datum 29.06.2021  
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 29.06.2021, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. “Familjet e Dëshmorëve në fshatin Morinë”, të cilën e përfaqëson Ajet Ukshini, në tekstin vijues Familjet e Dëshmorëve;

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi sipas kërkesë me numër 01-512/01-14712 e datës 10.06.2021, ka përqelli angazhimin e përbashkët në realizimin e procesit të rivarrimit të 8 dëshmorëve të fshatit Morinë që janë të varrosur në varrezat e dëshmorëve në Gjakovë, që do të rivarrosen në kompleksin Memorial “Dëshmorët e Morinës” në fshatin Morinë, që do të përruhet me datën 07.07.2021.

**Neni 2**  
**Obligimet e Komunës**

- 2.1 Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 5,700 euro për realizimin e të gjitha proceseve të rivarrimit të 8 dëshmorëve të fshatit Morinë.
- 2.2 Mjetet që do të ndahen përfundimin e procesit të rivarrimit të 8 dëshmorëve në fshatin Morinë, do të ekzekutohen pas pranimit të faturave e arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga “Familjet e Dëshmorëve nga fshati Morinë”.
- 2.3. Mjetet në vlerë prej 5,700 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime e Drejtorisë për Shërbime Publike.



**Neni 3**  
**Obligimet e “Familjet e Dëshmorëve”**

3.1 Obligohet të sjellë faturat, origjinal, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e saj.

3.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

**Neni 4**  
**Realizimi i rivarrosjes**

Realizimi i rivarrimit të 8 dëshmorëve të fshatit Morinë që janë të varrosur në varrezat e dëshmorëve në Gjakovë, do të rivarrosen në kompleksin Memorial “Dëshmorët e Morinës” në fshatin Morinë që do të përrohet me datën 07.07.2021.

**Neni 5**

Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëtin do ta zbatojnë në përpikmëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

**P A L È T**

**Komuna e Gjakovës**  
Ardian Gjini  


**Familjet e Dëshmorëve të fshatit Morinë**

Ajet Ukshini

